
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	PRISHTINA 
	Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	

Datë/a:	04.01.2019
Për/ Za/ To:	DRENI-A
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 31.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “DRENI-A”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Shërbimet e transportit me marimangë**”RITENDER, me Nr. të Prok: **616 18 069 211** nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjeserisht e bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “DRENIA-A”, të dt. 31.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet e transportit me marimangë**”, me Nr. të Prok: **616 18 069 211**, kundër **vendimit të Autoritetit Kontraktues**, të datës **24.12.2018** të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet vendimi i AK për LLOT I ndërsa vendimi për LLOT II ANULOHE**t dhe ai LLOT kthehet në rivlerësim.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për LLOT I ndërsa të rivlerësoj LLOT II.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 16.11.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Shërbimet e transportit me marimangë”RITENDER**, me Nr. të Prok: **616 18 069 211** , procedura e hapur.

Me datë 24.12.2018, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit duke dorëzuar Letrat Standarde për tenderuesit e suksesshëm/pasuksesshëm dhe eliminuar.

OE **“DRENI-A”**, me dt. 31.12.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Shërbimet e transportit me marimangë”RITENDER**, me Nr. të Prok: **616 18 069 211** , kundër vendimit të AK , në të cilin theksohet se AK ka **shkelur dispozitat e LPP per LLOT I dhe LLOT II**

Lidhur me pretendimet e tij sqarojmë si vijon:

- Pretendimi për LLOT I se OE i propozuar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm nuk është i bazuar për arsyet si vijon:
-grupi i OE-ik “Marimanga” shpk &NTSH “Marimanga” kane te regjistruar veprimtarinë për aktivitetet shërbyese për transportin tokësor dhe atë anëtari i parë NTSH MARIMANGA” e ka të regjistruar si aktivitet primarë ndërsa anëtari tjetër si aktivitet sekondar .Edhe pse mungojnë kodi 4942 dhe 5210 regjistrimi i veprimtarisë se cekur është i mjaftueshëm pasiqe veprimtaria e magazinimit dhe e ruajtjes është e panevojshme pasiqe kjo bëhet në lokacionin e Autoritetit Kontraktues,
- Lidhur me pretendimet se listat e kontratave të dy OE të tjerë grupit NTSH Marimanga” dhe “Marimanga “SHPK , si dhe të OE”Besa-Cola” se kontrata dhe referencat janë me data përafërsisht të njëjta nuk paraqet kurrfarë shkelje pasiqë sipas atyre datave janë realizuar.
- Poashtu pretendimet për refuzimin e qarkullimit nga kompanitë private janë të pabazuara pasiqë përpos tyre AK ka verifikuar pasqyrat financiare të pagesave për shërbimet e tyre dhe ka konstatuar se ato kërkesa plotësohen.
- Pretendimi se nuk ka ofruar dëshmi për automjetet e kërkuara poashtu është i paqëndrueshëm pasiqë dëshmit e ofruara nga tenderuesi i propozuar për kontratë ka dorëzuar mjetet sipas kërkesave të nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-së.
- Pretendimi se OE të cilit i është ndërprerë kontrata duhet të përjashtohet nga aktiviteti i prokurimit ju sqarojmë se kjo mundë të bëhet vetëm sipas vendimit të gjykatës e jo në bazë të vendimeve për ndërpreje të kontratës nga Autoritetet Kontratuese.
- Po ashtu pretendimi për korigjim të çmimeve është i paqëndrueshëm pasiqë në dosjen e tenderit kërkohet që të shënohen dy numra pas presjes dhjetore dhe ashtu janë paraqitur nga OE-ik ndërsa komisioni vetëm ka verifikuar këto dhe ka shënuar më shumë shifra që nuk janë obligative sipas dosjes së tenderit.

- Pretendimi për LLOT II, është pjesërisht i pazuar pasi që nga certifikata e biznesit të OE" BESA-COLA" shihet qart se nuk ka të regjistruar veprimtari që lidhet me kryerjen e këtyre shërbimeve .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv. Sipas kësaj Departamenti i prokurimit obligohet që të kërkojë dhe të formojë një komision për rivlerësim të LLOT II të këtij aktiviteti.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

